



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës  
Senca nr.2003/4  
Prishtinë, më 13 shkurt 2003, ora 10:15  
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse bashkëkryesues ishte z. Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë.  
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 104 deputetë dhe deklaroi të hapur punën e saj.

Për këtë seancë u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar;
3. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit "Për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Bankrotim-2003/2";
4. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit "Për Farërat-2003/1";
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit "Për Pyjet e Kosovës-2002/10"; dhe
6. Parashtrimi i pyetjeve.

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryesuesi** i informoi deputetët me iniciativën e 42 deputetëve që kanë kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të thërras seancën e jashtzakonshme të Kuvendit për të miratuar Deklaratën për shpalljen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur. Kryesia e Kuvendit, tha kryesusi, ka

proceduar me propozimin e rendit të ditës për seancë të rregulltë. Në ndërkohë, kryetarët e grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe të grupeve etnike joserbe i kanë harmonizuar qëndrimet lidhur me këtë çështje dhe e ftoi z. Hydajet Hyseni që t'i paraqesë qëndrimet e tyre.

**Hydajet Hyseni** e lexoi deklaratën e përbashkët të grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe të minoritetve të tjera në lidhje me nismën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën Shtet sovran dhe të pavarur të datës 3 shkurt 2003.

Grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës, shtoi z. Hyseni u pajtuan me sa vijon:

Përkrahin nismën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, të datës 3 shkurt 2003.

2 Nisma e deputetëve ka hyrë në procedurë të rregullt në Kuvendin e Kosovës dhe vazhdon shqyrtimi i saj.

Kryetarët e grupeve parlamentare marrin përsipër harmonizimin e qëndrimeve për Deklaratën e Pavarësisë me grupet parlamentare dhe me institucionet e tjera të pushtetit në Kosovë.

Deklarata e harmonizuar do të dalë për miratim në ndonjërin nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës në procedurë të rregullt në bashkëpunim të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të Kryesisë së Kuvendit.

Deklaratën e kishin nënshkruar, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së- Sabri Hamiti, të Grupit Parlamentar të PDK-së- Fatmir Limaj, të Grupit Parlamentar të AAK-së- Bujar Dugolli dhe në emër të Grupi Parlamentar të minoriteteve të tjera- Zylfi Merxha.

**Muhamed Kelmendi** tha se i përkrah qëndrimet e grupeve parlamentare lidhur me Deklaratën që e lexoi z. Hyseni, por ai kishte vërejtje në procedurën e saj për tri çështje: a) Deklarata nuk është nismë, por kërkesë e 43 deputetëve të Kuvendit; b) shqyrtimi i saj duhet të bëhet nga ana e deputetëve në seancë; dhe c) Kuvendi i Kosovës dhe as Kryesia e Kuvendit nuk kanë të drejtë që të mos e vënë në rend të ditës këtë çështje.

Kuvendi i Kosovës, shtoi z. Kelmendi, ka tri forma të vendosjes: a) të shpallë pavarësinë; b) ta refuzojë atë; dhe c) t'i pranojë rezultatet e Referendumit të vitit 1992. Ai kërkoi që lidhur me këtë çështje, lirisht të vendosin deputetët e Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutime të tjera, kryesusi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

## **2. Miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Deputeti Mahmut Bakalli pati vërejtje se nuk kishte hyrë edhe emri i tij në debatin e zhilluar lidhur me çështjen e sigurisë në Kosovë. Me këtë vërejtje u miartua procesverbali i seancës së kaluar.

## **3. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit "Për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Bankrotim-2003/2".**

**Kryesuesi** e ftoi kryeminitrin e Kosovës ta arsyetonte këtë P/Ligj.

**Kryeministri Bajram Rexhepi** tha se situata e rëndë ekonomike dhe sociale në Kosovë, e trashëguar nga e kaluara i obligon Qeverinë dhe Kuvendin që ta përgatitin rregullativën e nevojshme juridike për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, të bazuar në ekonominë e tregut të lirë. Në këtë drejtim, vazhdoi kryeministri, ky P/Ligj siguron: bazën juridike; juridiksionin e subjektit; trajtimin e barabartë të të gjitha palëve; zhvillimin ekonomik; ofron mjete efikase juridike për mbrojtjen e interesave të ligjshme të kreditorëve dhe të debitorëve. P/Ligji, në mënyrë të detajzuar rregullon çështjen e fillimit të procedurës së likuidimit dhe të riorganizimit të personave juridikë në bankrotim. Sipas tij, objekt i procedurës së likuidimit, përkatësisht riorganizimit është gjithë pasuria që ka debitori në kohën e paraqitjes së kërkesës dhe atë: pasuria e luajtshme dhe ajo e paluajtshme, materiale dhe jomateriale kudo që të jetë ajo. Me këtë P/Ligj rregullohet e dhe çështja e kufizimit të bartjes së pasurisë së debitorit: sekuestrimin, inventarizimin, pasurinë që është në transport etj.

Në përgatitjen e këtij P/Ligji, tha kryeministri janë angazhuar ekspertë të njohur vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe janë koordinuar punët me këshilltarin juridik të PSSP-së.

Në fund kryeministri Rexhepi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë P/Ligj.

**Kryesuesi** hapi debat lidhur me këtë P/Ligj.

**Znj. Nekibe Kelmendi** tha se ky P/Ligj është një ndër ligjet më të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Por në këtë P/Ligj theksoi ajo, nuk figuron se cilat subjekte ekonomike do t'i nënshtrohen falimentimit. Ajo pyeti se a do t'i pranohet subjeteve ekonomike statusi i personit juridikë që janë regjistruar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut? apo këtij procesi do t'i nënshtrohen vetëm ato kompani të regjistruara në regjistrin e komunave që kanë marrë licencën për biznes? Këtu ka paqartësi, shtoi ajo që duhet të sqarohen gjatë procedurës së shqyrtimit me anë të amendamenteve.

**Nerxhiyane Dauti** tha se ky P/Ligj është hartuar në bazë të standarteve më të larta ndërkombëtare të kësaj materie që rregullon procedurën gjyqësore për likuidimin e detyrueshëm të personave juridikë, që rrjedh nga paaftësia e pagesës apo insouvenca e debitorit e cila synon vlerësimin e pasurisë së ndërmarrjes së falimentuar me qëllim të përmbushjes së detyrimit ndaj kreditorëve. Me këtë P/Ligj, shtoi ajo krijohet një kornizë adekuate ligjore, ku përfshihen: a) kushtet për likuidimin dhe për riorganizimin e personave juridikë në falimentim; b) procedurat e likuidimit; dhe c) të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të përfshirë në këtë procedurë. Znj. Dauti pati edhe disa vërejtje konkrete në pjesën normative të P/Ligjit, që shtoi ajo, në emër të grupit parlamentar të PDK-së do t'i paraqesë në formë amendamentesh gjatë procedurës së shqyrtimit të tij.

**Naim Maloku** tha se në këtë P/Ligj duhet të përfshihen të gjitha subjektet afariste. Nuk dihet se sa janë borxhet e brendshme në mes subjekteve afariste, shtoi z. Maloku të cilat duhet të rregullohen me këtë P/Ligj.

Ky P/Ligj do të ndikojë edhe në zbutjen e kriminalitetit në Kosovë. Në shoqërinë kosovare theksoi z. Maloku, ka filluar një formë e kriminalitetit të organizuar, në grupe të caktuara, që marrin me nxjerrjen e borxheve me dhunë për llogari të firmave të ndryshme, nga të cilat ato

marrin një përqindje të caktuar. Me miratimin dhe me zbatimin e këtij P/Ligji, do të ulët kjo formë e aktivitetit kriminal në Kosovë.

**Haki Shatri** tha se ky P/Ligj është një ndër ligjet më të rëndësishëm për funksionimin e mekanizmave të ekonomisë së tregut. Me miratimin e tij, shtoi ai krijohen kushte për kreditimin e ndërmarrjeve private të domosdoshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe e përkrahu në parim, kurse për vërejtjet dhe sugjerimet në të duhet të inkorporohen në formë të amendamenteve.

**Ramadan Kelmendi** pati vërejtje në emërtimin e P/Ligjit dhe shtoi se emërtimi i tij nuk ka të bëjë me përmbajtjen e tekstit. Fjalët "likuidimi i personave juridikë" shtoi ai, duhet të zëvendësohen me: "shuarjen e personave juridikë". Z.Kelmendi tha se në parim e përkrah këtë P/Ligj, por pati vërejtje dhe sugjerime që do t'i paraqesë gjatë procedurës së shqyrtimit të tij në formë të amendamenteve.

**Dragisha Krstoviq** tha se në emër të koalicionit "Kthimi" parimisht e përkrahim këtë P/Ligj dhe gjatë procedurës së shqyrtimit të tij në komisione të Kuvendit shtoi, ai do të japin kontributin e tyre që ky P/Ligj të jetë sa më i mirë dhe që t'i përgjigjet shoqërisë kosovare.

Pas diskutimit të deputetëve, kryesuesi e vuri në votim këtë P/Ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për -----104;  
Kundër-----0;  
Abstenime—0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, në parim e miratoi P/Ligjin për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Bankrotim-2003/2.

#### 4. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit për Farërat-2003/1

**Kryesuesi** e ftoi ministrin e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural që ta arsyetojë këtë P/Ligj.

**Ministri Goran Bogdanoviq** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij P/Ligji ka qenë e madhe, ngase Ligji i vitit 1973 që ka rregulluar këtë materie, nuk ka mundur t'i përmbush nevojat dhe standardet të kësaj fushe me ato ndërkombëtare.

P/Ligji përmban katër kapituj, shtoi z.Bogdanoviq me të cilin normohet kjo materie.

Në kapitullin e parë të këtij P/Ligji është paraparë procedura e zbatimit të kriterëve për vendosjen e varieteve në regjistër; testimi i rritjes dhe vlerës përdoruese; funksionet; të drejtat e varieteve dhe procedurën e ankesës lidhur me to. Në kapitullin e dytë është përfshirë prodhimi, certifikimi dhe plasmani i farërave, në të cilën është paraparë mënyra dhe procedurat e prodhimit, të shumëzimit, të plasmanit, përpunimit, paketimit, dhe të etiketimit që nënkupton një skemë të certifikimit. Në kapitullin e tretë është rregulluar mënyra e kontrollit të farërave të importuara, kurse në të katërtën janë paraparë sanksionet për ata që nuk u përmbahen dispozitave të këtij P/Ligji.

Në hartimin e këtij P/ligji shtoi z.Bogdanoviq, kanë marrë pjesë ekspertë vendorë të ministrisë përkatëse dhe të institucioneve shkencore dhe ekspertët ndërkombëtarë .Ai i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë P/Ligj.

**Kryesuesi** hapi debat lidhur me këtë P/Ligj.

**Tomë Hajdaraj** pati vërejtje se në këtë P/Ligj janë përfshirë edhe prodhimi i fidaneve të pyjeve,pemëve dhe hardhisë së rrushit,gjë që sipas tij duhet rregulluar me Ligj të veçantë. Miratimi i këtij P/Ligji është i një rëndësie të veçantë shtoi z.Hajdaraj duke pasur parasysh se rreth 326 mij hektar të tokës deri tani janë mbjellë me farëra të paseleksionuara.Me këtë P/Ligj parashihet mënyra e përpilimit të rregullativave që parashohin standardet ndërkombëtare të kësaj fushe.Ky P/Ligj,shtoi z.Hajdaraj është praktik i standardizuar që gjatë shyrimit në Komisionin funksional do ta plotësohet me amendamente.

**Sebahate Grajçevci** tha se ky P/Ligj është hartuar mirë në pikëpamje profesionale dhe është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare të prodhimit dhe të tregtimit të farërave. Nevoja për këtë Ligj është ndierë shtoi ajo,ngase shumë kompani të paregjistruara e të paliçencuara për këtë fushë, janë marrë me importimin e farërave të cilësisë së dobët dhe kanë bërë shitjen e tyre pa asnjë kontrollë.Ajo sugjeroi se në këtë p/Ligj duhet të përfshihet edhe politika fiskale,me të cilën imortuesit e farërave dhe të repromaterialit të kësaj lëmie,duhet të lirohen nga akciza dhe dogana.

**Ibush Jonuzi** tha se ky P/Ligj është i një rëndësie të veçantë sepse me të rregullohet çështja e farërave.Ai shtroi çështjen e farërave të patateve dhe shtoi se për të pasur prodhime cilësore dhe rendimente të larta,duhet të jetë fara e cilësisë së lartë.Prej të gjitha prodhimeve bujqësore,patatja kërkon sasinë më të madhe të farës.Për mbjelljen e saj në një hektar nevojiten 2.000 kg farë.Prodhuesit tanë shtoi z.Jonuzi ,duhet të përkrahën, në mënyrë që të mos varen vetëm nga importimi i farërave nga vendet tjera,por të filojnë që ato të prodhohen edhe te ne.

**Berat Luzha** i falënderoi hartuesit e këtij P/Ligji që e kanë hartuar aq mirë,me një gjuhë të rrjedhshme,të qartë dhe për herë të parë të lektuar.Ai pati vërejtje në nenin 3 të P/ligjit në të cilin janë 39 pika dhe ishte i mendimit se ai duhet të thjeshtësohej.

Pas diskutimeve të deputetëve,kryesusi e vuri në votim këtë P/Ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----104;

Kundër-----0;

Abstenime----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për Farërat.

Pjesën e dytë të seancës e kryesoi z.Hydajet Hyseni,në të cilën morën pjesë 80 deputetë.

## 5. Shqyrtimi i dytë i P/Ligjit "Për Pyjet e Kosovës-2002/10".

**Berat Luzha** pati vërejtje në punën e Komisionit që ka përgatitur amendamentet në këtë P/Ligj. Komisioni funksional, shtoi ai me gjithë punën e madhe që ka bërë, nuk mund ta përmirësonte sa duhet tekstin e P/Ligjit, ngase ishte i hartuar dobët, i paqart dhe me kuptime të ndryshme. Mangësia kryesore e këtij P/Ligji sipas tij, është se komunat nuk kanë asnjë ingjerençë në menaxhimin e pyjeve. Ekonomitë e pyjeve shtoi ai, mbestën jashtë Ligjit dhe statusi i tyre mbetet i paqartë.

**Ministri Goran Bogdanoviq** dha shpjegime për vërejtjet e deputetit Berat Luzha. Vërejtja e z. Luzha se komunat nuk kanë ingjerenca në menaxhimin e pyjeve shtoi ai, mund të menjahen me decentralizimin e pushtetit lokal që ka premtuar z. Steiner. Por, edhe me Ligjin e vitit 1987 që rregullon këtë lëmi, komunat nuk kanë pasur kurrfarë ingjerençash lidhur me këtë çështje.

**Tomë Hajdaraj** paraqiti raportin në emër të Komisionit për Buqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Komisioni i ka mbajtur nëntë takime pune intensive, shtoi ai në të cilat u shqyrtua ky P/Ligj dhe ka përgatitur amendamentet në të, për të cilat është konsultuar me ekspertët vendorë dhe ata ndërkombëtar. I falënderoi ata për kontributin e dhënë në punën e këtij Komisioni. Komisioni shtoi z. Hajdaraj gjatë përpilimit të këtyre amendamenteve i pati parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që deputetët i kanë dhënë gjatë shqyrtimit të parë të tij, si dhe ato të ekspertëve të ndryshëm të kësaj fushe. Amendamentet e Komisionit funksional, shtoi ai që janë përkrahur nga dy Komisionet kryesore të Kuvendit. Z. Hajdaraj falënderoi të gjithë ata që me punën e tyre kanë kontribuar në hartimin e këtyre amendamenteve dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratojnë ato së bashku me tekstin e P/Ligjit që është shumë i nevojshëm për fushën që rregullon ai.

**Kolë Berisha** tha se Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe për Kornizën Kushtetuese e ka shqyrtuar këtë P/Ligj dhe ka konstatuar se ai nuk bie ndesh me kompetencat e rezervuara të PSSP-së, përkatësisht është në harmoni të plotë me nenin 5.1 të Kornizës Kushtetuese.

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit funksional që i kishin përkrahur edhe komisionet kryesore, një nga një. Prej amendamentit të parë deri tek i 34-ti u votua veç e veç për secilin dhe të gjithë deputetët i miratuan. Në ndërkohë deputeti Sllobodan Bjeliq propozoi që amendamentet e tjera të votohen në tërësi, meqë këtë e lejon Rregullorja e punës së Kuvendit dhe për ta racionalizuar kohën e miratimit të tyre. Deputetët e përkrahën propozimin e tij dhe i votuan amendamentet prej 35 deri tek 83-ti dhe të gjithë u miratuan me shumicë votash.

Kryesuesi e vuri në votim P/Ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----60;  
Kundër----1;  
Abstenime-11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Pyjet e Kosovës.

## **6. Parashtrimi i pyetjeve.**

Deputeti Ismajl Kurteshi i kishte parashtruar pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave z. Ali Sadriu lidhur me tatimin e të ardhuraave personale. Ministri Sadriu iu kishte përgjigjur me shkrim në pyejtjen e parashtruar dhe e ajo u është shpërndarë deputetëve.

Kryesuesi deklaroi të përfunduar seancën në orën 13:15 minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,  
akademik Nexhat Daci**